



Ky publikim është përgatitur nga Qendra e Pereresheme e Konferencave ne Qytete dhe Bashki, ne kuader te projektit Fushata Kombetare per Adoptimin dhe Zbatimin e Kodit Demokratik te Qeverisjes per Zyrtaret Lokale te Zgjedhur dhe Emeruar ne Serbi. Projekti ehste mbeshetur financiarisht nga Komisioni Europlan, Institutit i Shoqerise se Hapur,dhe Fondacioni Konrad Adenauer. Partnere te projektit jane gjithashtu Programi per Reformen e Veteqeverisjes ne Serbi, GTZ dhe Shoqata e Agjensive te Demokracise Lokale.

Ky dokument u publikua me mbeshetjen financiare te Bashkimit Europlan. Permbajtja e dokumentit është përgjegjesi e Qenderes se Pereresheme te Konferencave ne Qytete dhe Bashki, dhe nuk mund te perdoret per te prezantuar qendrimin e Bashkimit Europlan ne asnje rast.

#### Kontakt per Informacion:


Qendra e Pereresheme e Konferencave ne Qytete dhe Bashki  
Makedonska 22, 11000 Beograd  
+381 11 3223446  
+381 11 3221215  
[secretariat@skgo.org](mailto:secretariat@skgo.org)  
[www.skgo.org](http://www.skgo.org)

Projekti u mbeshet financiarisht nga:

Komisioni Europlan



Institutit i Shoqerise se Hapur



Fondacioni Konrad Adenauer



Partnere te tjere te projektit jane:

Programi per Reformen e Veteqeverisjes ne Serbi



Shoqata e Agjensive te Demokracise Lokale



Projekti i GTZ:  
Modernizimi i Sherbimeve Publike




Konferenca e perereshme  
qyteteve dhe Komunave



GRADIMO POVERENJE

## NDERTOJM MIRBESIMIN

KODEKSI ETIK I SJELLJES SË  
FUNKSIONARËVE TË VETADMINISTRATËS  
LOKALE NË SERBI



*Kuvendi i konferencës së Përhershme të qyteteve dhe komunave Me bindjen se aprovimi i kodeksit Etik të sjelljes së funksionarëve të vetadministratës lokale në Serbi, krijon kushte për ngritjen e besimit në mes të politikanëve dhe funksionarëve të vetadministratës lokale në një rën anë dhe të qytetarëve në anën tjetër;*

*Duke e ditur se respektimi i standardeve etike të funksionarëve dhe politikanëve të vetadministratës lokale është kusht për besimin e qytetarëve;*

*Të bindur se ndërtimi i besimit paraqet një kusht të domosdoshëm për kryerjen me sukses të obligimeve të funksionarit të vetadministratës lokale;*

*Duke pas në konsiderim se korpusi ligjor gjithnjë e më tepër dhe më shpesh po plotësohet me rregullat e sjelljes në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore;*

*Besojmë se është obligim i funksionarit të vetadministratës lokale që gjatë kryerjes së detyrave të ndërmarrin hapa të ngjajshëm për vetndërgjegjësim;*

*Konsidrojme se aprovimi i Kodeksit Etik për sjelljen e funksionarëve të vetadministratës lokale në Serbi do ta sqarojë rolin dhe përgjegjësinë e tyre dhe do të vërtetojë rëndësinë e këtyre përgjegjësisve;*

*Me këtë po bëjmë përpjekje që kodeksi Etik të përfshijë në masë sa më të madhe të gjitha segmentet e punës së funksionarit të vetadministratës lokale;*

*Duke theksuar se rregullat e punës të cilat parashihen me imperativin etik patjetër se duhen të respektohen;*

*Është e domosdoshme kyçja e shoqërisë në tërësi në krijimin dhe zhvillimin e ndjenjës së besimit duke theksuar rëndësinë e qytetarëve dhe të mediave në këtë proces;*

*Duke iu bashkuar përpjekjeve që vendi ynë të kyçet në integritet Evropian dhe në zbatimin e standardeve përkatëse në të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore;*

*Duke pasë për bazë rregullat që aktualisht në vendin tonë janë në fuqi, ndërsa kur të kihet parasyshë dokumentet e Këshillit të Evropës dhe të Unionit Evropian dhe të dokumenteve tjera relevante me të cilat rregullohet sfera e veprimtarisë së vetadministratës lokale dhe personelit të saj,*

Në seancën e saj të mbajtur më \_\_\_\_\_ të vitit 2004, aprovon kodeksin Etik të sjelljes së funksionarëve të vetadministratës lokale në Serbi, dhe ia preferon për aprovim kuvendeve të qyteteve dhe komunave dhe i ftonë të gjithë bartësit e funksioneve publike të vetadministratave publike të Serbisë që kësaj t'i bashkohen dhe në bazë të saj të sillen.

### *Neni 1. Definicioni*

Në kuptim të këtij kodeksi, funksionari i vetadministratës lokale (në tekstin vijues funksionari) është secili person i zgjedhur, i caktuar dhe i emëruar në organet e komunës, qytetit dhe të qytetit të Beogradit dhe në organet e ndërmarrjeve publike, enteve dhe të organizatave themelues i të cilave është komuna, qyteti dhe qyteti i Beogradit.

### *Neni 2. Lënda e Kodeksit*

Lënda e këtij kodeksi është definimi i standardeve etike të sjelljes me të cilat funksionari obligohet gjatë kryerjes së funksionit dhe informimi i qytetarëve me standardet e etike të sjelljes në të cilat ata kanë të drejtë të presin se funksionarët e vetadministratës lokale do t'i zbatojnë.

### *Neni 3. Përparësia e ligjit dhe interesit publik ndaj interesit privat*

Funksionari i vetadministratës lokale funksionin e tij e kryen në pajtim me ligjin. Gjatë kryerjes së detyrës së tij, funksionari vepron ekskluzivisht në interes publik, e jo për interesa personale, private, grupe ose për interesa partiake.

### *Neni 4. Rrespektimi i vullnetit zgjedhor të qytetarëve.*

Funksionari i zgjedhur i vetadministratës lokale obligimet e tija i kryen në kuadër të të drejtave dhe në pajtim me mandatin të cilin e ka fituar prej zgjedhësve dhe i përgjigjet të gjithë zgjedhësve të komunitetit lokal, përfshirë këtu edhe ata zgjedhës që nuk kanë votuar për atë ose edhe për listën zgjedhore prej të cilës është zgjedhur.

Duke rrespektuar vullnetin e zgjedhësve, e në veçanti kur është zgjedhur përmes listës partiake të kandidatëve, funksionari i zgjedhur i vetadministratës lokale duhet t'i shmanget asaj që gjatë mandatit të tij të ndërrojë partinë të cilës i ka takuar gjatë zgjedhjeve.

### *Neni 5. Mënyra e kryerjes së funksionit publik*

Funksionari i vetadministratës lokale e kryen funksionin e tij publik me ndërgjegje, me nder dhe i paanshëm dhe vendimet dhe sjelljet e tija duhet të jenë publike dhe të përgjegjshme.

Funksionari do të angazhohet në avansimin e punës së vetadministratës lokale dhe në këmbimin e përvojave të cilat i organizojnë pushteti qendror dhe ai lokal.

Funksionari i vetadministratës lokale, gjatë mandatit të tij nuk guxon që, as gjatë kryerjes së funksionit e as në jetën private me sjelljet e tija të degradojë prestigjin e funksionit që e kryen.



### **Neni 6. Raporti ndaj funksionarëve të tjerë, me të punësuarit dhe me qytetarët**

Gjatë kryerjes së funksionit të tij, funksionari i rrespekton të drejtat e të gjithë funksionarëve dhe zyrtarëve të tjerë, dhe se ai me nder dhe rrespekt do të silllet me qytetarët, kolegët, të punësuarit dhe mediat.

Funksionari i vetadministratës lokale nuk do të nxisë e as të ndihmoje funksionarët dhe zyrtarët e tjerë me rastin e kryerjes së obligimeve të veta t'i shkelin parimet e vendosura me këtë kodeks.

Funksionari publikishtë do t'i paraqese të gjitha rastet e sjelljeve antiligjore dhe kundër rregullave të këtij kodeksi.

## **KAPITULLI II STANDARDET GJATË KRYERJES SË FUNKSIONIT**

### **Kreu 1. Principet e përgjithshme**

#### **Neni 7. Ndalimi i konfliktit të interesave**

Funksionari i vetadministratës lokale nuk do t'i kryej obligimet e veta, përkatësishtë nuk do ta përdore autorizimin e pozitës së tij me qëllim të realizimit të interesave të tija personale apo grupore. Funksionari do t'i shmanget ç'do forme të sjelljes e cila mund të çojë deri te dhënia e përparësisë së interesave private kundrejt interesave publike, edhe nëse një sjellje e tillë nuk është formalishtë e ndaluar.

#### **Neni 8. Publikimi i të dhënave për gjendjen ekonomike**

Funksionari i vetadministratës lokale do t'i përmbahet të gjitha rregullave në fuqi të cilat parashohin obligimin e publikimit të të dhënave për gjendjen e pasurisë.

#### **Neni 9. Kufizimi i kryerjes së më shumë funksioneve**

Funksionari i vetadministratës lokale do t'i rrespektojë kufizimet ligjore në drejtim të kryerjes së njëkohëshme të më shumë funksioneve publike.

Funksionari do t'i shmanget kryerjes së funksioneve të tjera publike, përkatësishtë veprimtarive të cilat e pengojnë në kryerjen e obligimeve të tija.

### **Kreu 2. Sjellja e personave të zgjedhur para marrjes së funksionit**

#### **Neni 10. Fushata zgjedhore**

Fushata zgjedhore e kandidatit për zgjedhje në funksion të caktuar në vetadministratën lokale ka për qëllim që qytetarëve të iu ofroj sa më shumë informata dhe sqarime për programet politike të kandidatëve. Kandidati nuk do të anoj që votat e zgjedhësve t'i fitoj ndryshe por vetëm se përmes bindjes së tyre me argumentim. Në veçanti, kandidati nuk do të tentojë t'i fitojë votat përmes akuzimit të kandidatëve të tjerë, duke shfrytëzuar dhunën ose kërcënimin, keqpërdorimin e funksionit të cilin e kryen, e as me ofrimin ose premtimin ekundërvlerës së shërbimit.

### **Neni 11. Shpenzimet e fushatës zgjedhore**

Kandidati për funksionar në vetadministratën lokale për fushatën e tij zgjedhore do të bëjë shpenzime të arsyeshme. Kandidati do të japë të dhëna të sakta dhe të plota për natyrën dhe shumën e shpenzuar gjatë fushatës së tij zgjedhore.

### **Kreu 3. Sjellja gjatë kryerjes së funksionit**

#### **Neni 12. Papërputhshmëria e funksioneve mbykqyrëse**

Funksionari i vetadministratës lokale nuk do të përzihet në punën e atyre organeve dhe trupave kur ato organe dhe trupa merren me mbikqyrjen e punës së tij.

Funksionari nuk do të punësohet, e as që do të merr pjesë në punën e organeve dhe trupave mbi të cilat kryen mbikqyrjen sipas detyrës zyrtare.

#### **Neni 13. Mënyra e vendosjes**

Gjatë procesit vendimmarrës, funksionari i vetadministratës lokale në masë dhe mundësi sa më të madhe do t'i mer në konsideratë qëndrimin e qytetarëve të shprehur në diskutim publik ose edhe në forma të tjera.

Gjatë vendosjes funksionari nuk do t'i ofrojë vetes kurrfarë dobie të drejtëpërdrejtë apo të tërthort personale e as që do të tentojë në realizimin e interesave private të individëve apo grupeve të caktuara.

#### **Neni 14. Publikimi i ndeshjes së interesave**

Nëse ndodhë që funksionari i vetadministratës lokale, gjatë diskutimit dhe vendosjes për ndonjë çështje dhe vendos organ apo trupin anëtarë i së cilës është, ai e ka për obligim që me rastin e pjesëmarrjes në debat, e më së voni para fillimit të marrjes së vendimit, të informojë për ekzistimin e një interesi të tillë privat. Funksionari do të përmbahet prej ç'fardoqoftë deklarate apo votimi për çështjet me të cilat e lidhin interesat private.

#### **Neni 15. Arsyetimi i Vendimeve**

Funksionari i vetadministratës lokale me rastin e ç'do vendimi të tij do të jep sqarime kur prej tij këtë e kërkojnë qytetarët, duke i përmendur të gjitha faktet dhe rrethanat në të cilat bazohet ai vendim, e në veçanti se cilat rregulla janë zbatuar. Në mungesë të rregullave, arsyetimi i vendimit do të përfshijë elementet siç janë dëshmimi i për atë se vendimi është marr duke pas në konsideratë drejtësinë drejtëpeshueshmërinë dhe pëlqimin me interesin publik.

#### **Neni 16. Lufta kundër korrupsionit**

Funksionari i vetadministratës lokale gjatë kryerjes së funksionit do të përmbahet nga sjelljet, ç'fardoqofshin ato, e të cilat në bazë të së drejtës penale ndërkombëtare apo vendore, mundë të karakterizohen si nxitje për korrupsion në formë aktive apo pasive.

Funksionari do të angazhohet aktivisht në zbulimin dhe luftën kundër të gjitha formave të korrupsionit në komunitetin lokal.



#### **Neni 17. Ndalimi i marrjes së dhuratave**

Funksionari i vetadministratës lokale nuk do të kërkojë apo pranojë, përkatësisht as që do t'i lejojë ndonjë personit tjetër që në emër të tij ose edhe në dobi të tij të pranojë dhurata, shërbime, mikpritje ose edhe ç'fardoqoftë lloj tjetër të dobisë lidhur me kryerjen e funksionit, përveç dhuratave me vlerë minimale e të parapara me protokol apo edhe të rasteve solemne.

#### **Kreu 4. Mbikqyrja**

##### **Neni 18. Disiplina buxhetore dhe finansiare**

Gjatë drejtimit dhe shfrytëzimit të mjeteve publike funksionari i vetadministratës publike do të veprojë me kujdesin e një nikoqiri të mirë.

Funksionari do t'i përmbahet disiplinës finansiare dhe buxhetore me të cilën sigurohet udhëheqja e drejtë me të ardhurat publike, në mënyrën e rregulluar me rregullat në fuqi.

Funksionari nuk do të ndërmer asgjë që do të mundë të shkaktoje që mjetet buxhetore të shfrytëzohen drejtëpërsëdrejti apo edhe tërthorazi për qëllime private.

##### **Neni 19. Bashkëpunimi në zbatimin e masave të mbikqyrjes**

Funksionari i vetadministratës lokale nuk do të pengojë zbatimin e ç'fardo mase të bazuar në ligj nga ana e organit të kontrollit të mbrendshëm apo të jashtëm.

Funksionari me përpikmëri do t'i përmbahet secilit vendim të atyre organeve qofshin ato vendime përfundimtare apo edhe të përkohëshme.

#### **Kreu 5. Raportet me të punësuarit në vetadministratën lokale**

##### **Neni 20. Sjellja shembullore**

Funksionari i vetadministratës lokale me sjelljen e tij do të paraqesë një shembull të mirë ndaj të gjithë të punësuarve në organet dhe organizatat e vetadministratës lokale.

##### **Neni 21. Punësimi dhe shpërndarja**

Gjatë punësimit, shpërndarjes caktimit, sistematizimit dhe avansimit të të punësuarve funksionari i vetadministratës publike i bie vendimet e bazuara ekskluzivishtë në aftësitë e tyre profesionale dhe në pajtim me qëllimet, mundësitë dhe nevojat e shërbimit.

##### **Neni 22. Rrespektimi i rolit të të punësuarve**

Funksionari i vetadministratës lokale me rrespekt do të silltet me të punësuarit në shërbim dhe nuk do të ndikojë te ata që të veprojnë kundër ligjit, ose që zyrtarishtë të ndërmarin ose edhe të bëjnë lëshime ose të ndërmarin diçka me të cilën do të mundësohej, vet atij apo edhe personave apo edhe grupeve të tjera, dobia e drejtëpërdrejtë apo e tërthortë personale (private).

##### **Neni 23. Avansimi i rolit të të punësuarve**

Funksionari i vetadministratës lokale do të përpiqet të siguroj që roli dhe detyrat e të punësuarve në shërbim të realizohen në tërësi. Funksionari do të ndërmarë dhe do të nxisë masa dhe aktivitete të cilat kontribuojnë në avansimin e funksionimit të shërbimit apo drejtoratit për punën e të cilit është përgjegjës si dhe për motivimin e të punësuarve të cilët e kryejn atë punë.

Funksionari i vetadministratës lokale do të krijojë kushte për avansimin e njohurive të veta dhe aftësisë profesionale si dhe njohurit dhe aftësitë profesionale të të punësuarve në shërbim.

#### **Kreu 6. Sjellja me rastin e përfundimit të funksionit.**

##### **Neni 24. Ndërprerja në kryerjen e funksionit**

Funksionari i vetadministratës lokale nuk do të ndërmarë aktivitete ndaj organizatave dhe ndërmarrjeve ndaj të cilave kryen mbikqyrjen, me të cilat jan vendosur mardhënje kontraktuese ose që jan themeluar gjat kohës së mandatit të tijë, ashtu që vetes apo dikujt tjetër ti sigurojë privilegje personale dhe profesionale pas përfundimit të kryerjes së funksionit.

### **KAPITULLI III RAPORTET ME OPINIONIN**

##### **Neni 25. Puna publike**

Funksionari i vetadministratës lokale do të përpiqet të siguroj që puna e tijë të jetë publike e gjithashtu të jetë publike edhe funksionimi i shërbimit dhe organit për punën e të cilit është përgjegjës. Funksionari do të përgjigjet në ç'do kërkesë të paraqitur publikisht e që ka të bëjnë me kryerjen e funksionit të tijë, arsyetimin e veprimeve të tija apo funksionimin e shërbimit dhe organit për punën e të cilit është përgjegjës.

##### **Neni 26. Raportet me mediat**

Funksionari i vetadministratës lokale do të përgjigjet sakt dhe me kohë ndaj të gjitha kërkesave të përfaqësuesve të mjeteve të informimit publik për dhënien e informatave lidhur me kryerjen e funksionit të tij, porse nuk do të jep asnjë informatë të besueshme zyrtare ose informatë që ka të bëjë me jetën private të personave të tjerë.

Funksionari do të nxisë në ndërmarrjen e të gjitha masave të cilat kanë për qëllim avansimin e përcjelljes së punës së tij nga ana e mediave ose edhe për funksionimin e shërbimit apo drejtoratit për punën e të cilit është përgjegjës.

##### **Neni 27. Njohtimi i funksionarit me përmbajtjen e Kodeksit**

Funksionari i vetadministratës lokale do të njohtohet me përmbajtjen e këtij Kodeksi dhe do të deklarohet se është i gatshëm t'i nënshtrohet dispozitave të tij.

##### **Neni 28. Njohtimi i opinionit me përmbajtjen e Kodeksit**

Funksionari i vetadministratës lokale do të punojë në promovimin e këtij Kodeksi në mesin e të punësuarve në kuadër të shërbimit, në opinion dhe media, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për parimet e Kodeksit dhe për rëndësinë që ka rrespektimi i tij në funksionimin e vetadministratës lokale.

